

Terma Reference
Njoftim për punësim

Konsulenca	Menaxher rasti për mbështetjen e procesit të deinstitutionalizimit në Bashkinë Shkodër
Projekti	Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbimin cilësor të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe parandalimit dhe përgjigjes ndaj GBV-së
Kohëzgjatja e projektit	Maj 2024 – Prill 2025
Lloji i kontratës	Kontratë individuale pune
Data e fillimit të punës	01 Qershor 2024

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë punonjës social lokal për Bashkinë Shkodër si specialist në fushën e shërbimeve për mbështetjen e fëmijës dhe familjes me fokus procesin e deinstitutionalizimit dhe parandalimit të ndarjes në kuadër të projektit “Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbimin cilësor të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe parandalimit dhe përgjigjes ndaj GBV-së” zbatuar në partneritet me UNICEF.

Informacion i Përgjithshëm:

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Profili i menaxherit të rastit

Nën mbështetjen dhe supervizimin e plotë të drejtuesit të ekipit të Nisma ARSIS, menaxheri i rastit do të ketë këto përgjegjësi:

- Të ndjekë me përpikmëri dhe të zbatojë me profesionalizëm të gjithë planin e aktiviteteve, metodologjinë dhe detyrat e ngarkuara nga drejtuesi i ekipit dhe të sigurohet që të arrihen në përputhje me standardet e Nisma ARSIS;
- Si pjesë e strukturës koordinuese në nivel lokal (drejtues dhe staf i Institucionit të Përkujdesit Shoqëror (IPSH), pmf/njmf, staf i DRSHSSH, etj.) merr pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në çdo mbledhje të strukturës koordinuese vendore si dhe në takimet e grupit teknik ndërsektorial

sa herë të jetë nevoja;

- Mbështet punonjësien e mbrojtjes së fëmijëve në zhvillimin dhe zbatimin e planit për fuqizimin e familjes duke adresuar nevojat e familjes biologjike dhe të fëmijës që është vendosur në IPSH, vizita në familje, takime, lehtësim me institucionet mbështetëse, duke patur në vëmendje dhe çështje të parandalimit të institucionalizimit të fëmijëve të tjerë që ndodhen në familje, etj;
- Ofron mbështetje direkte me shërbime në përputhje me planin e ndërhyrjes për fuqizimin e familjes dhe fëmijës dhe në mënyrë të koordinuar me strukturat e shërbimeve sociale në nivel vendor bazuar në termat e projektit.
- Mbështet aktorët vendorë (stafin e IPSH dhe të Bashkisë) në procesin e ribashkimit të fëmijëve me familjen (biologjike dhe të gjerë) ose vendosjen e tij në dhe familje kujdestare;
- Dokumenton në mënyrë shkresore çdo takim, shërbim, vizitë në familje, komunikim me prindërit apo me anëtarët e grupit vendor brenda afateve kohore me cilësi dhe në përputhje me objektivat e synuara.

Kualifikimet:

- Diplomë bachelor në degët Punë Sociale , Psikologji;
- Diplomë në master shkencor në profilet përkatëse (preferohet në çështje të fëmijëve dhe familjes, drejtimi klinik, apo që kanë lidhje);
- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe familjeve;

Eksperiencat:

- Të ketë experiencë pune në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve / mbrojtjes sociale;
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile (preferohet);
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës ligjore për politikën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërveprimi në punën në grup;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Word, Excel, email, etj
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren;
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS dhe Politikën të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 01 qershor 2024.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar në këtë pozicion të dërgojnë në adresën e emailit:

info@nisma-arsis.org deri në datën **22 maj 2024**, mesnatë.

Në vëmendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim për menaxher rasti-Shkodër

Ju lutemi, në vëmendjen tuaj që vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.